

LIGJ
Nr.10 215, datë 21.1.2010

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR” , TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika l dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kufiri minimal i regjistrimit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 5 të këtij neni.”.

Neni 2

Neni 7 “Çregjistrimi” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7
Çregjistrimi

1. Personi i tatueshëm i regjistruar detyrohet të kërkojë çregjistrimin jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit, kur ai ka kryer furnizime të tatueshme, si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike.

2. Personi i tatueshëm, që kërkon të çregjistrohet, u nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Personi i tatueshëm detyrohet të çregjistrohet, sipas këtij ligji, vetëm nëse plotëson kushtet sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Organet tatimore refuzojnë të regjistrojnë dhe të çregjistrojnë çdo person, që nuk është as i detyruar dhe as ka të drejtë për t’u regjistruar, me efekt nga data që ky person nuk ka të drejtë të regjistrohet.

5. Në çastin e çregjistrimit, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një formular deklarimi, i cili përmban informacionet, që kërkohen nga organi tatimor, si dhe të bëjë pagesën përfundimtare.”.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19
Furnizimet e përjashtuara

1. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar, nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8, 25.9 e 26.1 të këtij ligji.

2. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim se cili prej furnizimeve të përjashtuara, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, nuk është një furnizim i përjashtuar në kushte e rrethana të përcaktuara.”.

Neni 4

Pas nenit 24 “Organizatat jofitimprurëse” shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore, publike dhe private, në përputhje me ligjet nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 tetor 2010, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 5

Pas nenit 25.8 shtohet neni 25.9 me këtë përmbajtje:

“Neni 25.9
Shërbimet ndërkombëtare

Furnizimi i shërbimeve të bëra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit është në Shqipëri, ose në rastin e një individi, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 6

Në nenin 26/1 “Furnizimet e përjashtuara në import”, shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 7

Neni 31 “Eksporti dhe shërbimet ndërkombëtare” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31
Eksporti dhe transporti ndërkombëtar

TVSH-ja zbatohet në masën zero për qind:

1. Për mallrat, që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve dhe furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me të.

Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kanë të drejtë të caktojnë me udhëzim të përbashkët cilat janë furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

3. Për furnizimet e mallrave a shërbimeve në lidhje me veprimtaritë tregtare ose industriale në det.”.

Neni 8

Në nenin 50 “Rimbursimet”, në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.”.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6393, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**